



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 2-4/2019 regjistër (JR)
Datë 10.01.2022

Nr. 12 i vendimit
Datë 19.04.2024

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

| | |
|------------------------|------------------|
| Natasha Mulaj | Kryesuese |
| Ina Rama | Relatore |
| Albana Shtylla | Anëtare |
| Rezarta Schuetz | Anëtare |
| Sokol Çomo | Anëtar |

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në datat 02.04.2024 dhe 19.04.2024, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Theo Jacobs, me Sekretare Gjyqësore Adelajda Hiska, çështjen që i përket:

KËRKUES: Artor Ylli, i datëlindjes {***}, lindur në Skrapar, banues në Tiranë, në adresën rruga “{***}”, nr. {***}.

OBJEKTI: Rishikimi i vendimit të formës së prerë nr. 31 (JR), datë 20.11.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

BAZA LIGJORE: Nenet 3, 4, pikat 1, 5, 6, 7, 15, 42 dhe 116, pikat 1, 122 dhe 124 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6§1 i Konventës Evropiane të të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut; nenet 494 - 498/a të Kodit të Procedurës Civile; neni 45 i ligjit nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë”, i ndryshuar; nenet 28-33 të ligjit “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, analizoi pretendimet e kërkuarit në kërkesat e paraqitura prej tij dhe parashtrimet me shkrim, i cili përfundimisht kërkoi rishikimin e vendimit nr. 31 (JR), datë 20.11.2019, të Kolegjit, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Ina Rama, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Kërkuari Artor Ylli (në vijim “kërkuari”) i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*, sipas përcaktimeve të nenit 179/b të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”). Pas hetimit administrativ të zhvilluar, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), me vendimin nr. 73, datë 02.11.2018, vendosi: “*Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Artor Ylli, me funksion ndihmës ligjor pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë*”. Kërkuari e ka kundërshtuar këtë vendim në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit (në vijim “Kolegji”), i cili pas shqyrtimit të ankimit të paraqitur prej tij, me vendimin nr. 31 (JR), datë 20.11.2019, vendosi: “*Lënien në fuqi të vendimit nr. 73, datë 02.11.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Artor Ylli*”.
2. Në vendimin nr. 31, datë 20.11.2019, Kolegji ka çmuar se *në këtë proces të rivlerësimit kalimtar, sipas ligjit nr. 84/2016 dhe nenit 179/b, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, subjekti i rivlerësimit (Artor Ylli) ndodhet para situatës së administrimit, përdorimit, posedimit dhe disponimit të një pasurie në emër të tij, me shuma financiare mbi 56.000 USD, të administruara nëpërmjet procedurave haptazi të kundraligjshme, të parashikuara nga legjislacioni fiskal shqiptar, ligji për doganat, ligji për tatimet, gjë që e çon subjektin e rivlerësimit në situatën e mosmarrjes së masave të arsyeshme prej tij për të ruajtur dinjitetin e funksionit, me veprimtarinë e tij të ushtruar jashtë funksionit të tij zyrtar. Në përfundim të gjykimit të çështjes, Kolegji ka vlerësuar se vendimi nr. 73, datë 02.11.2018, i Komisionit është i drejtë dhe duhet të lihet në fuqi, sipas përcaktimeve të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, pasi në vlerësimin tërësor të procedurave, në kuptim të nenit 4, pika 2 e këtij ligji, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë dhe ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit.*
3. Në vijim, kërkuari Artor Ylli i është drejtuar Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim “GjEDNj”), me aplikimin nr. 11640/20 kundër Republikës së Shqipërisë, datë regjistrimi 20.02.2020.
4. Gjithashtu, kërkuari Artor Ylli ka paraqitur në Kolegji dy kërkesa për rishikimin e vendimit të formës së prerë me nr. 31, datë 20.11.2019 (JR), të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

4.1. Kërkesa e parë është regjistruar në Kolegj me nr. 22 prot., datë 10.01.2022, në Regjistrin e Çështjeve të Juridiksionit të Rivlerësimit si çështja me nr. 2-4/2019. Në këtë kërkesë, kërkuesi parashtron se nga burime të hapura është bërë me dije se në datën 09.12.2021, Kolegji i Posaçëm i Apelimit ka vendosur shkarkimin nga detyra të gjyqtarit L. D, si pasojë e dënimit të tij me vendim të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale. Më pas i është drejtuar gjykatave përkatëse për vënie në dispozicion të vendimeve në ngarkim të ish-gjyqtarit L. D, si dhe Kolegjit për të qartësuar situatën faktike/ligjore të ushtrimit të detyrës prej këtij gjyqtari. Duke evidentuar vendimet e gjykatave të juridiksionit të posaçëm penal dhe të Gjykatës së Lartë në ngarkim të ish-gjyqtarit L. D, në bazë të së cilave Kolegji ka dhënë masën disiplinore të shkarkimit të tij nga detyra, kërkuesi shprehet se kërkesa për rishikim është dorëzuar brenda afatit 30-ditor të marrjes dijeni për shkakun e rishikimit, parashikuar në nenin 496 të Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë [në vijim “K.Pr.Civile”], si dhe brenda afatit 4-mujor të parashikuar në nenin 71/a, shkronja “b” e ligjit nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë”, i ndryshuar, plotëson në mënyrë kumulative të gjithë kushtet e përcaktuara nga germa “c” e nenit 494 të K.Pr.Civile dhe dispozitat vijuese të këtij Kodi, dhe kërkon përfundimisht: (i) pranimin e kërkesës; (ii) rishikimin e vendimit nr. 31 (JR), datë 20.11.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit; si dhe (iii) prishjen tërësisht të vendimit nr. 31 (JR), datë 20.11.2019, dhe gjykimin e çështjes në themel.

4.2. Ndërlidhur me kërkesën e sipërcituar, kërkuesi, më datë 30.01.2022, ka depozituar disa akte shkresore¹; më datë 17.02.2022 ka paraqitur kërkesë për përshpejtim të procedurës së gjykimin të kërkesës së tij; më datë 15.12.2022 ka kërkuar informacion lidhur me regjistrimin/shqyrtimin e kërkesës së tij dhe kopje dokumentacioni, për ta komunikuar si dokumentacion plotësues pranë GjEDNj-së për aplikimin e tij nr. 11640/20 të depozituar pranë kësaj gjykate më 20.02.2022²; më datë 20.01.2023, lidhur me deklaratën e një vëzhguesi ndërkombëtar të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, që sipas kërkuesit shpreh paragjykim të kërkesës së tij për rishikim vendimi³; më datë 08.05.2023 ka paraqitur tre

¹ Përmes shkresës së administruar në Kolegj me nr. 22/6 prot., kërkuesi parashtron se më datë 28.12.2021 i është drejtuar GjKKO-së me kërkesën për vënie në dispozicion të vendimit të datës 01.12.2020, në ngarkim të ish-gjyqtarit L. D, vendim i cili i është njoftuar vetëm në datën 12.01.2022.

Bashkëlidhur kërkuesi përcjell:

- (i) shkresën nr. 1632/1 prot., datë 05.01.2022, të GjKKO-së në përgjigje të kërkesës të protokolluar më datë 29.12.2020, ku kërkoni kopjen e vendimit me nr. 32., datë 01.12.2020 [...];
- (ii) kopje të njehsuar të vendimit nr. 32, datë 01.12.2020, të GjKKO-së, me shënimet përkatëse lidhur me vendimin nr. 5, datë 08.03.2021, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; dhe (iii) vendimin nr. 00-2021-670 (63), datë 26.10.2021, të Gjykatës së Lartë.

² Shkresa është administruar në Kolegj me nr. 1646 prot., datë 15.12.2022.

³ Shkresa e kërkuesit drejtuar trupit gjykoës, për dijeni ONM-së, me lëndë “Lidhur me deklaratën e paligjshme, të një vëzhguesi ndërkombëtar të ONM-së, në shkelje të rënda të ushtrimit të detyrave të tij si vëzhgues ndërkombëtar të parashikuara në Aneksin e Kushtetutës, neni B”, është administruar në Kolegj me nr. 591/15 prot., datë 20.01.2023. Kërkuesi Artor Ylli referon në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Kolegji, në përgjigje të kërkesës së tij me nr. 591/14 prot., datë 17.10.2023. Konkretisht, kërkuesit i është vënë në dispozicion kopja e procesverbalit të mbledhjes së datës 13.10.2023, ku pas marrjes në shqyrtim të kërkesës së Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, nr. 668 prot., datë 30.05.2023, me lëndë “Dhënie përparësi të çështjeve të depozituara nga ish-subjektet e rivlerësimit sipas nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile”, është vendosur pranimi

kërkesa: -- për përshpejtim të procedurës -- për pezullim të ekzekutimit të vendimit për të cilin kërkon rishikimin -- për thirrjen në gjykim si palë të interesuar të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (në vijim “ONM”); më datë 23.05.2023 ka paraqitur kërkesë për gjykim të drejtë dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm; më datë 16.11.2023 kërkesë që çështja e tij të dëgjohet në seancë gjyqësore publike; më datë 20.12.2023 kërkesë për thirrjen si palë të interesuar të Kuvendit të Shqipërisë.

4.3. Kërkesa e dytë është regjistruar në Kolegj me nr. 143/2 prot., datë 14.02.2024. Në objektin e kësaj kërkesë, përpos sa përcaktuar në objektin e kërkesës së datës 10.01.2022, kërkuesi shton që çështja e tij të dëgjohet në seancë gjyqësore publike dhe kërkon pezullimin e ekzekutimit të vendimit objekt rishikimi. Lidhur me pranueshmërinë e kërkesës, pretendon se kërkesa për rishikim është dorëzuar brenda afatit 30-ditor të marrjes dijeni për shkakun e rishikimit, parashikuar në nenin 496 të K.Pr.Civile të Republikës së Shqipërisë, si dhe brenda afatit 4-mujor të parashikuar në nenin 71/a, shkronja “b” e ligjit nr. 8577/2000. Lidhur me afatin, kërkuesi citon vënien në dispozicion në datën 22.01.2024, me kërkesë të tij, të vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë të datës 21.03.2023, marrë pas rigjykimit të çështjes së kërkuesit L. D, në zbatim të vendimit nr. 21/2022, të Gjykatës Kushtetuese.

4.4. Në datën 19.02.2024, me nr. 143/5 prot., kërkuesi Artor Ylli ka kërkuar ndryshimin e bazës ligjore të kërkesës së regjistruar me nr. 2-4/2019 (JR), datë 10.01.2022, nga neni 494, germa “c” e K.Pr.Civile në nenin 494, germa “a” e K.Pr.Civile dhe me nr. 143/6 prot., ka kërkuar që dy kërkesat për rishikimin e vendimit të formës së prerë, datë 10.01.2022, regjistruar me nr. 2-4/2019 dhe datë 14.02.2024, regjistruar me nr. 143/2 prot., si dhe provat e paraqitura me to t’i komunikohen palëve të interesuara Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe ONM-së.

5. Trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në nenin 448 të K.Pr.Civile dhe nenin 19, pika 1/1 të Rregullores “Për veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit të Gjykatës Kushtetuese”, me vendim të ndërmjetëm, vendosi bashkimin në një proces të vetëm të dy kërkesave të paraqitura prej kërkuesit, të cilat kanë të njëjtin objekt “Rishikimin e vendimit nr. 31 (JR), datë 20.11.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit”. Ky vendim, i marrë në seancën gjyqësore në dhomë këshillimi në datën 02.04.2024, ju njoftua kërkuesit së bashku me datën dhe orën e zhvillimit të seancës së ardhshme.

II. Pretendimet e kërkuesit

6. Kërkesat për rishikimin e vendimit nr. 31 (JR), datë 20.11.2019, të Kolegjit, bazohen në nenin 494, shkronjat “a” dhe “c” të K.Pr.Civile dhe mbështeten në argumentin se trupi gjykues i Kolegjit, që shqyrtoi çështjen e tij, nuk përbënte *gjykatë të krijuar me ligj*, sipas nenit 6/1 të KEDNj-së, pasi ish-gjyqtari L. D, i shkarkuar në vitin 1997 nga detyra e gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nuk kishte përmbushur kushtet e zgjedhshmërisë për t’u emëruar

i saj dhe për çështjen (JR) me nr. 2-4/2019, datë 10.01.2022, që i përket kërkesës së ish-subjektit të rivlerësimit Artor Ylli.

gjyqtar i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, për pasojë vendimi i dhënë është i cenueshëm dhe çështja e tij duhet të rishikohet nga Kolegji.

7. Në kërkesën e parë për rishikim, regjistruar si çështja me nr. 2-4/2019, kërkuesi pretendon se me vendimin nr. 31 (JR), datë 20.11.2019, të Kolegjit, i janë shkëlur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara nga neni 42 i Kushtetutës *e drejta për një proces të drejtë gjyqësor* dhe neni 6 i KEDNj-së *e drejta për një proces të rregullt*. Kërkuesi parashtron se pretendimet për *tribunalin e themeluar me ligj dhe pavarësisë dhe paanshmërisë* burojnë nga i njëjti problem themelor: parregullsitë në emërimin e z. L. D si gjyqtar i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Sipas kërkuesit, veprimtaria kriminale e z. L. D ka përcaktuar emërimin e tij si gjyqtar dhe ka ndikuar në dhënien e vendimit të trupës gjyqësore në dëm të interesave të tij themelore kushtetuese, ndikim me karakter krejtësisht specifik, pasi vendimi është bazuar në votën e tre anëtarëve të trupit gjykues, një prej të cilave vota e ish-gjyqtarit L. D, duke shtrembëruar shumë fakte lidhur me procesin e rivlerësimit të tij si gjyqtari relator i çështjes. Kërkuesi argumenton se: (i) ish-gjyqtari L. D nuk plotësonte kushtet ligjore për të ushtruar detyrën e gjyqtarit, parashikuar në ligjin nr. 84/2016; (ii) emërimi i ish-gjyqtarit L. D në detyrë u bë jo për faj të vlerësimit të gabuar të fakteve dhe dokumenteve nga organi kompetent i emërtesës, por për shkak të veprave penale të kryera me faj nga ish-gjyqtari L. D. Fakti që ish-gjyqtari L. D, për të realizuar rrimërimin në detyrën e gjyqtarit ka kryer vepra të dënueshme penalisht, për të cilat është dënuar me vendim penal të formës së prerë, komprometojnë legjitimitetin e trupës gjyqësore në dhënien e vendimit për kërkuesin.

7.1. Në shkresat/kërkesat e depozituara në vijim të kërkesës së parë për rishikim, të cituara në paragrafin 4.1. më lart në këtë vendim, në mënyrë të përmbledhur, kërkuesi ka sjellë në pah dhe kërkon:

7.2. Përcaktimin e një date sa më të shpejtë për procedurat vijuese të shqyrtimit të kërkesës për rishikim, për shkak se *shkarkimi nga detyra ka passjellë edhe ndërprerjen e studimeve të tij në Shkollën e Magistraturës, si kandidat për profilin gjyqtar*.

7.3. Pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 31 datë 20.11.2019, të Kolegjit, sipas kërkuesit, kërkesë e justifikuar nenit 500 të K.Pr.Civile,⁴ dhe me qëllim frenimin e ardhjes së pasojave shtesë përfshirë pasojat disiplinore të parashikuara nga akti.

7.4. Thirrjen si palë të interesuar të ONM-së. Sipas kërkuesit, ONM-së i takonte të përdorte të gjithë mjetet që kishte në dispozicion për të garantuar se gjyqtarët e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit të përmbushnin kërkesat statutores për pozicionin e tyre, ndërkohë që nuk i është referuar ndonjë vështirësie për të verifikuar nëse z. L. D kishte qenë subjekt i masës disiplinore të shkarkimit nga detyra në të shkuarën, dhe informacioni ishte në të dhënat zyrtare dhe i cituar jo më vonë se në vitin 2016, në skualifikimin e z. L. D nga kandidimi për pozicionin e gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

⁴ Kodi i Procedurës Civile, në nenin 500 “Pezullimi i ekzekutimit”, parashikon: “Paraqitja e kërkesës për rishikim nuk pezullon ekzekutimin e vendimit. Por gjykata, me kërkesën e palës, mund të pezullojë ekzekutimin e vendimit, kur vlerëson se ka rrezik që mund të shkaktohet një dëm i madh e i pariparueshëm”.

7.5. Thirrjen si palë të interesuar të Kuvendit të Shqipërisë. Sipas kërkesit shtetet kanë detyrim të përgjithshëm për të organizuar sistemet e tyre ligjore, në mënyrë që të sigurojnë pajtueshmërinë me kërkesat e nenit 6 të KEDNJ-së. Kuvendi duhet të përdorte të gjithë mjetet që kishte në dispozicion dhe *kishte detyrimin* të verifikonte se aplikimi i z. L. D plotësonte kërkesat për pozicionin e gjyqtarit, dhe nuk iu referua ndonjë vështirësie për të verifikuar nëse z. L. D kishte qenë subjekt i masës disiplinore të shkarkimit nga detyra në të shkuarën.

8. Në kërkesën e dytë për rishikim, regjistruar në Kolegj me nr. 143/2 prot., datë 14.02.2024, të cilën e bazon në nenin 494, germa “c” e K.Pr.Civile, duke iu referuar tashmë vendimit nr. 00-2023-406 (76) , datë 21.03.2023, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, që la në fuqi vendimin nr. 05, datë 08.03.2021 të Gjykatës së Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, pas rigjyqimit të çështjes mbi bazën e urdhërimit të vendimit nr. 21/2022, të Gjykatës Kushtetuese, kërkesi parashtroi të njëjtat argumente lidhur me *gjykatën e krijuar me ligj*, lidhur me praninë e ish-gjyqtarit L. D, për të cilin është provuar me vendim gjyqësor të formës së prerë se ka kryer vepra të dënueshme penalisht, të cilat kanë ndikuar thelbësisht drejtpërdrejtë në dhënien e vendimit ndaj tij. Në këtë kërkesë, kërkesi riparashtroi argumentet lidhur me legjitimitimin e ONM-së dhe Kuvendit të Shqipërisë në këtë proces. Gjithashtu, kërkesi pretendon për cenim të parimeve të barazisë së armëve dhe procedura kontradiktore në shqyrtimin e kërkesës për rishikim, shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm nga një gjykatë e pavarur, sipas tij, për shkak të ndërhyrjeve të shumta të ONM-së, që sipas Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë do të mbështeste dhe monitoronte procesin e rivlerësimit.
9. Në kërkesën e datës 19.02.2024, me bazë ligjore nenet 185/1 dhe 494/a të K.Pr.Civile, kërkesi ka kërkuar ndryshimin e bazës ligjore të kërkesës së regjistruar me nr. 2-4/2019 (JR), datë 10.01.2022, nga neni 494, germa “c” e K.Pr.Civile në nenin 494, germa “a” të po këtij kodi. Argumentet e kërkesit paraqiten në mënyrë të përmbledhur si vijon:

9.1. Në kërkesën për rishikim të vendimit të formës së prerë, paraqitur në datën 10.01.2022, ka përcaktuar si bazë ligjore germën “c”, të nenit 496 të K.Pr.Civile, pasi në trupin gjykues që ka dhënë vendimin nr. 31, datë 20.11.2019, ka qenë anëtar ish-gjyqtari L. D, për të cilin është provuar me vendim gjyqësor të formës së prerë se ka kryer vepra të dënueshme penalisht, të cilat kanë ndikuar drejtpërdrejt dhe thelbësisht në dhënien e vendimit objekt i kërkesës për rishikim.

9.2. Pas paraqitjes në datën 10.01.2022 të kërkesës për rishikim, kanë ndodhur ngjarjet që i përkasin juridiksionit kushtetues. Në datën 17.01.2022, z. L. D i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me ankim kushtetues individual, duke kërkuar shfuqizimin si antikushtetues të vendimeve gjyqësore që kanë vendosur fajësinë e tij. Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr. 21, datë 26.09.2022, ka vendosur shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 00-2021-670, datë 26.10.2021 dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Lartë. Për shkak të këtyre ngjarjeve, kërkesi vlerëson se aspekti i përshtatshmërisë së z. L. D në detyrë kishte të bënte me një rregull themelor në lidhje me emërimin e gjyqtarëve të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, fakt i cili passjell ndryshimin e bazës ligjore të kërkesës në nenin 494,

germa “a” të K.Pr.Civile, ku parashikohet se nga pala mund të kërkohet rishikimi i një vendimi të formës së prerë, kur zbulohen rrethana apo prova të reja me shkresë që kanë rëndësi për çështjen, të cilat nuk mund të dihen gjatë shqyrtimit të saj. Në vijim të shtjellimit të argumenteve, kërkuesi citon qëndrimin e GjEDNj-së, në çështjen *Sevdari kundër Shqipërisë*, vendim i datës 13.12.2022: “Procesi penal kundër z. L. D kishte të bënte me aspektin nëse ai kishte kryer falsifikim në aplikimin për pozicionin e gjyqtarit në Kolegj, kjo problematikë është e ndryshme nga problematika lidhur me faktin nëse emërimi i tij ishte i ligjshëm”.

III. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Procesi gjyqësor në Kolegj

Juridiksioni i Kolegjit

10. Trupi gjykues, në funksion të përcaktimit të juridiksionit të tij për gjykimin e kërkesave për rishikim, mori në shqyrtim fillimisht çështjen nëse Kolegji i Posaçëm i Apelimit, si një gjykatë e ngritur posaçërisht për të ushtruar funksionet e së vetmes gjykatë brenda procesit të rivlerësimit kalimtar, është pajisur me tagrat kushtetuese dhe ligjore për të pasur pjesë të juridiksionit të tij rishikimin e vendimeve të marra po prej tij, sipas parashikimeve të nenit 494 të K.Pr.Civile. Për të konkluduar lidhur me sa më lart, si një parakusht për shqyrtimin në themel të pretendimeve të kërkuesit, trupi gjykues, shtroi për zgjidhje çështjet e mëposhtme:
 - i. Nëse ka një parashikim ligjor që përcakton juridiksionin rishikues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit ndaj vendimeve të dhëna prej tij.
 - ii. Nëse me anë të një interpretim teleologjik të dispozitave kushtetuese dhe ligjore mund të arrihet në përfundimin se Kolegji i Posaçëm i Apelimit e ka fituar këtë juridiksion rishikues.
 - iii. Si mund të mbrohen të drejtat e subjekteve të rishikimit për një proces të rregullt ligjor, kur ato janë shkelur nga gjykimi i çështjeve të tyre në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit dhe të korrigjohet një gabim gjyqësor që shoqëron një vendim të dhënë me këto shkelje.
11. Lidhur me çështjen e parë të shtruar për zgjidhje, *trupi gjykues mori në analizë dispozitat kushtetuese dhe ligjore që rregullojnë procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, e që përcaktojnë rolin dhe funksionet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.*
 - 11.1. Procesi i rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, si një proces i rëndësishëm i reformës në drejtësi, u ndërmor nga ligjvënësi si një nevojë për të adresuar problemet e lindura nga shkalla e lartë e korrupsionit në sistemin e drejtësisë, për çlirimin e këtij sistemi nga influencat e jashtme, me qëllim rikthimin e besimit të publikut në të dhe te Shteti i së Drejtës⁵. Për paketën kushtetuese dhe ligjore, mbi të cilën kryhet procesi i

⁵ Neni 179/b, pika 1 e Kushtetutës parashikon se: “Sistemi i rivlerësimit ngrihet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, si edhe të rikthehet besimi i publikut tek institucionet e këtij sistemi”.

rivlerësimit kalimtar, Komisioni i Venecias është shprehur se: “[...] është i mendimit që këto masa jo vetëm janë të justifikuar, por janë të nevojshme që Shqipëria të mbrohet nga korrupsioni, i cili, nëse nuk trajtohet, mund të shkatërrojë plotësisht sistemin gjyqësor. E gjithë skema është më e qartë dhe jep garanci më të mira për individët që mund të preken nga vlerësimi”⁶.

11.2. Sipas nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës: “Rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, ndërsa ankimet e subjekteve të rivlerësimit ose të Komisionerit Publik shqyrtohen nga Kolegji i Apelit pranë Gjykatës Kushtetuese”. Kjo dispozitë kushtetuese përcakton juridiksionin e Kolegjit, fushën e veprimtarisë së tij si organi gjyqësor që ka juridiksion kontrollues mbi vendimet e Komisionit, i vënë në lëvizje nëpërmjet ankimit të subjekteve të rivlerësimit ose Komisionerit Publik.

11.3. Në të njëjtën frymë dhe parashikueshmëri vijon kjo dispozitë kushtetuese në pikën 8 të saj, në të cilën, ndërsa parashikon se mandati i anëtarëve të Kolegjit, si një dhomë e dytë e Gjykatës Kushtetuese, mbaron me kalimin e një afati 9-vjeçar, përcakton se me kalimin e tij ankimet ndaj vendimeve të Komisionit ende të papërfunduara do të shqyrtohen nga Gjykata Kushtetuese, duke potencuar sërish juridiksionin e rivlerësimit të Kolegjit, i cili transferohet te Gjykata Kushtetuese, e që lidhet me gjykimin e ankimeve ndaj vendimeve të Komisionit. Në këtë mënyrë kushtetutëbërësi ka pasur në vëmendje të definojë se edhe me mbarimin e mandatit të Kolegjit e vijimin e aktivitetit të tij në fushën e rivlerësimit kalimtar nga Gjykata Kushtetuese, objekt kontrolli, për pasojë juridiksionin i kësaj gjykate në këtë proces, mbetet vetëm shqyrtimi i ankimeve ndaj vendimeve të Komisionit.

11.4. Në pikën 10 të po kësaj dispozite, neni 179/b i Kushtetutës, parashikohet se: *Procedurat dhe kriteret e rivlerësimit rregullohen sipas parashikimeve të Aneksit dhe ligjit*, duke përcaktuar në këtë mënyrë edhe rregullin referues dhe kuadrin ligjor të zbatueshëm për procesin e rivlerësimit, si ai i parashikuar në Aneksin e Kushtetutës dhe në ligjin e posaçëm që do të miratohej për këtë qëllim. Në këtë mënyrë, Kushtetua ka shpallur natyrën e posaçme të procesit të rivlerësimit, si edhe ka përcaktuar në mënyrë të shprehur parimin e njohur të së drejtës *lex specialis derogat legi generali*. Në këtë kuptim, rregullimi i posaçëm i procesit nëpërmjet kuadrit ligjor të përcaktuar nga Kushtetuta është ai në të cilin do të duhet të gjejnë zbërthim dhe detajim parashikimet kushtetuese për rregullat që duhet të ndjekë procesi i rivlerësimit, por edhe për juridiksionin e Kolegjit.

11.5. Në këtë kontekst, në funksion të çështjes së parë të shtruar për zgjidhje, më tej, trupi gjykues vijoi me analizën mbi dispozitat e posaçme të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, që rregullojnë tagrat e Kolegjit në kuadër të këtij procesi. Sipas parashikimit të nenit F, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, *Kolegji i Apelit përbëhet nga shtatë gjyqtarë dhe është organi i vetëm gjyqësor që shqyrton ankimet kundër vendimeve të Komisionit, sipas këtij Aneksi dhe ligjit*, duke përcaktuar në vijim të njëjtin rregull mbi juridiksionin e Kolegjit si ai që lejon atë të shqyrtojë ankimet kundër vendimeve të Komisionit.

⁶ Shih opinionin e Komisionit të Venecias, të ndërmjetëm CDL-AL (2015)045 dhe opinionin final CDL-AL (2016) 009.

11.6. Dispozita, gjithashtu, vijon me përcaktimin e rregullave procedurale mbi të cilat Kolegji i Posaçëm zhvillon procesin gjyqësor për ushtrimin e juridiksionit të tij rivlerësues dhe kontrollin mbi vendimet e marra nga Komisioni dhe të ankimuara prej subjekteve të rivlerësimit apo Komisionerit Publik. Rregullat e përcaktuara në këtë dispozitë përcaktojnë fushën e juridiksionit rivlerësues të Kolegjit, përmes kontrollit mbi vendimet e Komisionit, pa përcaktuar apo hedhur dritë për ndonjë juridiksion tjetër kontrollues mbi vetë vendimet e Kolegjit.

11.7. Trupi gjykues, duke ndjekur këtë logjikë, vijoi me analizën e dispozitave të ligjit të posaçëm nr. 84/2016, i cili u miratua në zbatim të dispozitave kushtetuese për të përcaktuar rregullat mbi kriteret e rivlerësimit dhe procedurat e kryerjes së këtij procesi kalimtar, sipas përcaktimit të nenit 179/b, pika 10 e Kushtetutës. Sipas nenit 5, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, parashikohet juridiksioni i Kolegjit, i cili vjen si zbatim logjik i parashikimeve kushtetuese të përshkruara më sipër, duke përcaktuar se *Kolegji i Apelit shqyrton ankimet ndaj vendimeve të Komisionit dhe ka mandat 9-vjeçar.*

11.8. Në vijim, kreu VIII i ligjit, i titulluar “Apelimi”, në nenet 62, 63, 64 e 65 të tij, parashikon sërish të drejtën e subjekteve dhe të Komisionerit Publik për të ankimuar vendimet e marra në Komision, në Kolegj, garancitë që subjekteve u burojnë përgjatë periudhës së pritjes prej tyre për gjykimin nga Kolegji të ankimeve, si edhe rregullat mbi të cilat gjykohen ankimet në Kolegj. Në mënyrë të posaçme, këto rregullime flasin për të drejtën e subjekteve procedurale për të ankimuar vendimet e Komisionit pranë Kolegjit, si e vetmi mjet procedural garantor për procesin e rregullt ligjor, pas marrjes së vendimit të Komisionit. Duket se ligjvënësi në këtë kre ka synuar të potencojë rrethin e të drejtave të palëve që garantojnë procesin e rregullt ligjor brenda këtij procesi, të cilat përfaqësohen nëpërmjet së drejtës së ankimit ndaj vendimeve të Komisionit, si edhe të drejtave të tjera të subjekteve për t’u dëgjuar e mbrojtur në gjykimin në apel apo edhe ato me natyrë financiare e që lidhen me ruajtjen e vendit të punës deri në përfundimin e procesit në Kolegj.

11.9. Në të drejtat e konceptuara si garanci pas dhënies së vendimit të Komisionit, nuk parashikohet e drejta e subjekteve në drejtim të paraqitjes së kërkesës për rishikim të vendimeve të Kolegjit, si një pjesë e paketës së garancive që ligji ofron brenda kuadrit të këtij procesi. Në këtë kuptim, duket se edhe në këtë kontekst, ligji nr. 84/2016 nuk ka një parashikim literal për të drejtën e përdorimit të këtij mjeti të jashtëzakonshëm ankimi prej subjekteve të rivlerësimit, si një e drejtë e parashikuar për t’u ushtruar brenda kuadrit të këtij procesi dhe për t’u zgjidhur nga organet e rivlerësimit brenda tij dhe në zbatim të urdhërimeve të tij të posaçme.

11.10. Referuar parashikimeve të ligjit nr. 84/2016, Kolegji, si hallka përmbyllëse e këtij procesi, ka tiparet e një gjykate jo të zakonshme me juridiksion të specializuar, sikundër është shprehur edhe Komisioni i Venecias, ndër të tjera, se [...] *Nga dispozitat kushtetuese dhe legjislative duket se organet e rivlerësimit, pra, Komisioni i Pavarur dhe Kolegji i Apelit kanë të dy karakteristikat e organeve gjyqësore [...] . Përveç faktit se këto nuk janë institucione të përhershme, duket se qëllimi i dispozitave kushtetuese dhe ligjore është që t’i pajisë ato me karakteristikat e gjykatave të zakonshme. [...] Kolegji i Apelit mund të konsiderohet si një*

*juridiksion i specializuar, krijimi i të cilit nga dispozitat kushtetuese mund të interpretohet si një specifikim i fushës së veprimit të nenit 135 të Kushtetutës (gjykatat) dhe në mënyrë të veçantë i paragrafit 2 të tij (gjykatat e posaçme). [...] Kolegji i Apelimit mund të konsiderohet si një juridiksion i posaçëm i cili i jep garanci gjyqësore personave të prekur nga procedura e vettingut [...]*⁷. Neni 135 i Kushtetutës, i referuar në opinionin e sipërcituar, parashikon: “3. Kuvendi mund të krijojë me ligj gjykata të tjera për fusha të veçanta, por në asnjë rast gjykata të jashtëzakonshme”.

11.11. Në konkluzion të analizës së bërë më lart, trupi gjykues arrin në përfundimin pajtues se i gjithë kuadri kushtetues dhe ligjor që rregullon procesin e rivlerësimit nuk ka asnjë parashikim të shprehur literal, *së pari*, për të drejtën procedurale të paraqitjes së kërkesës për rishikim të subjekteve të rivlerësimit brenda kuadrit të zhvillimit të këtij procesi, *së dyti*, dhe, për pasojë, as për ndonjë kompetencë/tagër të Kolegjit që ushtrohet tej funksionit kontrollues të vendimeve të Komisionit në kuadër të juridiksionit të rivlerësimit, mbi bazën e ankimeve të paraqitura nga subjektet dhe Komisioneri Publik.

11.12. Trupi gjykues vëren se konkluzioni i mësipërm mbështetet edhe nga fryma dhe qasja e institucioneve të tjera, të huaja dhe vendase, që kanë kontrolluar kushtetutshmërinë dhe përqasjen e kuadrit rregullator me të drejtën ndërkombëtare, atë të Bashkimit Evropian dhe Kushtetutën e vendit, të cilat e kanë konfiguruar dhe konceptuar/përshkruar Kolegjin si organi i vetëm gjyqësor që shërben për të mbrojtur të drejtat substanciale të subjekteve të procesit, përmes të drejtës procedurale të ankimit ndaj vendimeve të Komisionit. Në këtë linjë, Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 2/2017 ka mbajtur qëndrimin se: “[...] në vlerësim të dispozitave kushtetuese rezulton se ato kanë përcaktuar kompetencën kushtetuese të Kolegjit të Apelimit, duke e konceptuar atë si organ gjyqësor për ankimimin e vendimit të KPK-së. Në nenin 43 të Kushtetutës parashikohet se: “Kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj për kundërvajtje të lehta penale, për çështje civile ose administrative me rëndësi ose vlerë të vogël, në përputhje me kushtet e parashikuara në nenin 17 të Kushtetutës”. Gjykata Kushtetuese ka theksuar se e drejta themelore e ankimit, e sanksionuar në nenin 43 të Kushtetutës, është një e drejtë procedurale, që shërben për të mbrojtur një të drejtë substanciale. Kjo e drejtë bazohet në parimin se “[...] nuk mund të ekzistojë një e drejtë pa të drejtën e ankimit” ose “[...] nuk ka të drejtë ankimi pa pasur një të drejtë”. Ajo duhet kuptuar si mundësi e çdo individi për të pasur mjete të caktuara procedurale për të kundërshtuar vendimin e dhënë nga një gjykatë më e ulët në një gjykatë më të lartë, duke i garantuar individit të drejtën për t’u përballur me drejtësinë në të gjitha nivelet e saj. Kushtetuta i garanton individit të drejtën për t’u ankuar të paktën një herë ndaj një vendimi gjyqësor të dhënë ndaj tij. Gjykata vlerëson se nga mënyra e cilësimit të Kolegjit të Apelimit në Kushtetutë dhe në ligjin për rivlerësimin kalimtar, këto tekste ligjore parashikojnë elemente të mjaftueshme për të arritur në përfundimin se ai mund të konsiderohet si një juridiksion i posaçëm, i cili u jep garanci gjyqësore personave të prekur nga procedura e rivlerësimit dhe se të drejtat dhe garancitë e përfshira në skemën legjislative dhe kushtetuese duket se janë mjaft të gjera (shih edhe opinionin CDL-AD (2016)036, të Komisionit të

⁷ Shih opinionin CDL-AD (2016)036 *amicus curiae* të Komisionit të Venecias, paragrafët 29, 32 dhe 46.

Venecias)”⁸. Në këtë kuptim, trupi gjykues vlerëson se garancitë ligjore të përmendura në vendimin e sipërcituar i referohen mbrojtjes ligjore në Kolegj nëpërmjet shqyrtimit të ankimeve, përderisa këto garanci lidhen me procedurën e rivlerësimit, e cila, sipas nenit 179/b, pika 5⁹ e tij, kryhen nga Komisioni.

11.13. Duke konsideruar faktin se norma kushtetuese bëhet realitet gjatë interpretimit, pra, gjatë procesit vendimmarrës të gjykatës, duke e bërë këtë të fundit burim parësor të së drejtës, duke pasur parasysh se Kushtetuta është ligji më i lartë në Republikën e Shqipërisë, referuar qëndrimin të Gjykatës Kushtetuese se *në vlerësim të dispozitave kushtetuese rezulton se ato kanë përcaktuar kompetencën kushtetuese të Kolegjit të Apelimit, duke e konceptuar atë si organ gjyqësor për ankimimin e vendimit të KPK-së*, trupi gjykues vlerëson se ky qëndrim orienton qartë juridiksionin e Kolegjit në procesin e rivlerësimit kalimtar. Njëherazi, mbajtur në konsideratë qëndrimin e kësaj gjykate se *nisur nga tagrat që i jep neni 124 i Kushtetutës, roli dhe funksioni i Gjykatës Kushtetuese është që nëpërmjet vendimeve të transformojë dispozitat kushtetuese nga abstrakte-metafizike, në substanciale dhe konkrete, duke i garantuar mbrojtje kushtetuese situatave juridike në të cilat ndodhen individët*”¹⁰ dhe faktin që në interpretimin e normës kushtetuese, nenin F të Aneksit të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese nuk ka evidentuar që në kompetencën e Kolegjit të bëhet pjesë edhe shqyrtimi i ankimit të jashtëzakonshëm -- kërkesës për rishikim të vendimeve të dhëna prej atij vetë, potencohet deduksioni i arritur më sipër.

11.14. Për sa më sipër, në lidhje me çështjen e parë të shtruar për zgjidhje, trupi gjykues arrin në konkluzionin se dispozitat e Kushtetutës, Aneksit të saj dhe ligjit nr. 84/2016, lidhur me procesin e rivlerësimit kalimtar, parashikojnë dhe përcaktojnë në mënyrë të shprehur vetëm juridiksionin rivlerësues të Kolegjit lidhur me kontrollin ndaj vendimeve të marra prej Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, juridiksion i ushtruar mbi ankimin e subjekteve të rivlerësimit dhe Komisionerit Publik. Nga analiza e kuadrit rregullator të posaçëm, nuk rezulton të ketë asnjë parashikim eksplicit për ushtrimin e juridiksionit rishikues të Kolegjit, sipas kërkesës së parashikuar prej kërkuesit Artor Ylli, në çështjen objekt shqyrtimi. Mungesa e një parashikimi të tillë në ligjin e posaçëm, e shoqëruar edhe me mungesën e rregullave për trajtimin e kërkesave të tilla, e çoi trupin gjykues në nevojën e analizës së dispozitave që thirren për zbatim me referim, nëse nëpërmjet tyre mund të aplikohet/ushtrohet ky juridiksion rishikues i pretenduar prej kërkuesit.

⁸ Shih vendimin nr. 2/2017, të Gjykatës Kushtetuese, paragrafët 65 dhe 66. Qëndrimi i Komisioni i Venecias, i referuar nga Gjykata Kushtetuese në këtë vendim, është si vijon: “Për sa i përket pyetjes nëse mungesa e mundësisë së gjyqtarëve dhe prokurorëve, që i nënshtrohen procesit të vetting-ut për të kundërshtuar vendimet e marra nga institucionet e rivlerësimit para gjykatave kombëtare përbën shkelje të nenit 6 të KEDNj-së, Komisioni i Venecias konsideron se përgjigjja e kësaj pyetje varet nga mënyra e cilësimit të Kolegjit të Apelimit në Kushtetutë dhe në ligjin e vetting-ut. Për Komisionin e Venecias, këto tekste ligjore parashikojnë elemente të mjaftueshme për të arritur në përfundimin se Kolegji i Apelimit mund të konsiderohet si një juridiksion i posaçëm, i cili i jep garanci gjyqësore personave të prekur nga procedura e vettingut. Të drejtat dhe garancitë e përfshira në skemën legjislativë dhe kushtetuese duket se janë mjaft të gjera”.

⁹ Rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur të Kualifikimit, ndërsa ankimet e subjekteve të rivlerësimit ose të Komisionerit Publik shqyrtohen nga Kolegji i Apelimit pranë Gjykatës Kushtetuese.

¹⁰ Shih vendimin nr. 20, datë 01.06.2011, të Gjykatës Kushtetuese.

12. Lidhur me çështjen e dytë të shtruar për zgjidhje, nëse mund të arrihet me anë të një interpretimi teleologjik të dispozitave kushtetuese dhe ligjore në përfundimin se Kolegji i Posaçëm e ka fituar këtë juridiksion rishikues, trupi gjykues analizoi si vijon.

12.1. Në vijim të analizës së bërë më sipër, trupi gjykues mori në shqyrtim dispozitat e tjera të legjislationit të përgjithshëm, *generalis*, që janë të zbatueshme në procesin e rivlerësimit për të analizuar/zbërthyer qëllimin e legjislatorit drejt tagrave dhe fushëveprimit të Kolegjit brenda këtij procesi.

12.2. Sipas nenit 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, parashikohet se *kur është rasti, institucionet e rivlerësimit mund të zbatojnë edhe procedurat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative ose në ligjin "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", nëse këto procedura nuk janë parashikuar nga dispozitat e Kushtetutës ose të këtij ligji*. Të dy ligjet e cituara në këtë dispozitë janë thirrur për zbatim prej Kolegjit çdo herë që nevoja për të zbatuar procedura të caktuara në funksion të zgjidhjes së çështjeve apo situata të ndryshme faktike që janë paraqitur para tij nuk kanë pasur një rregullim eksplicit në ligjin e posaçëm. Në këto raste, Kolegji ka identifikuar normën ligjore brenda këtij legjislationi për të përcaktuar rregullin procedural që duhej të zbatohet për zgjidhjen e një situate duke garantuar në çdo rast zbatimin e parimeve të një procesi të rregullt ligjor, të drejtat e subjekteve në proces, si edhe pasjen në konsideratë të qëllimit të miratimit të kësaj pakete ligjore, që synon kthimin e besimit të institucionet e drejtësisë.

12.3. Në kushtet kur legjislationi i cituar në nenin 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016 nuk parashikon, po ashtu, në mënyrë të shprehur asnjë rregull për institutin e rishikimit, si një mjet i jashtëzakonshëm ankimi, duke ndjekur të njëjtën logjikë, trupi gjykues, në zbatim të nenit 1, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, sipas së cilit *dispozitat e këtij ligji plotësohen me parashikimet e Kodit të Procedurës Civile, me përjashtim të rasteve dhe për aq sa ky ligj nuk parashikon ndryshe*, mori në analizë, për t'i dhënë përgjigje çështjes së dytë të shtruar për zgjidhje, dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, që rregullojnë këtë institut, në nenet 494 e vijues të tij.

12.4. Referimi të dispozitat e K.Pr.Civile që rregullojnë institutin e rishikimit, ndonëse thirren për zbatim, sipas rregullit të përdorur më lart, në rast të nevojës për plotësim apo të mungesës në legjislation të një rregulli procedural të posaçëm për të zgjidhur një çështje, trupi gjykues mori në analizë nëse ndërtimi i këtij mekanizmi kontrolli të jashtëzakonshëm të vendimit të formës së prerë vjen në përputhje me qëllimin e legjislatorit edhe në rastin konkret, lidhur me tagrat e atribuuar organeve të rivlerësimit dhe posaçërisht Kolegjit. Trupi gjykues, duke analizuar rrethanat/shkaqet e mëposhtme, arriti në konkluzionin se Kolegji i Posaçëm i Apelit nuk ka juridiksion rishikues si një prej tagrave të tij dhe nuk është ngritur për t'i dhënë jetë këtij instituti sipas rregullimeve të përgjithshëm të tij, parashikuar në nenet 494 e vijues të K.Pr.Civile.

12.5. *Së pari*, Kolegji është ngritur dhe parashikuar të funksionojë si gjykata e vetme e procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, mbështetur në rregullimet e posaçme të sipërcituara, në të cilat nuk parashikohet shprehimisht as e drejta e subjekteve për

të paraqitur para tij kërkesën për rishikim, si një mjet garantor i posaçëm në kuadër të këtij procesi dhe as juridiksioni i tij rishikues ndaj vendimeve të tij, përveçse ai i rivlerësimit, bazuar në ankime mbi vendimet e Komisionit.

12.6. *Së dyti*, procesi i rivlerësimit kalimtar është një proces i jashtëzakonshëm i parashikuar të zgjasë vetëm për një periudhë kohe të kufizuar. Për shkak të natyrës së tij disiplinore të posaçme, efektit kontrollues mbi magjistratët dhe nevojës për të siguruar një ekuilibër mes këtij kontrolli të jashtëzakonshëm dhe garantimit të pavarësisë dhe paanësisë së magjistratëve në ushtrimin e funksioneve të tyre, mandati i Kolegjit është parashikuar të jetë i kufizuar deri në 9 vjet. Kufizimi në kohë i mandatit të Kolegjit kushtëzohet edhe me veprimtarinë e parashikuar të ushtrohet prej tij, e cila lidhet dhe është e ndërvarur prej organit që kryen procesin e rivlerësimit, që është Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, vendimet e të cilit Kolegji kontrollon. Kushtetuta ka përcaktuar, gjithashtu, edhe mandatin e këtij organi, duke mundësuar në këtë mënyrë, një raport të drejtë e logjik e të parashikueshëm, mbi çështjen dhe ngarkesën e Kolegjit, praktikisht mbi fushën e veprimtarisë së tij, e cila duhet të ushtrohet në funksion të kontrollit të organit tjetër, brenda 9 viteve të mandatit. Në këtë logjikë, në se Kushtetuta dhe ligji do të kishin synuar/parashikuar edhe juridiksionin rishikues të Kolegjit mbi vendimet e dhëna prej atij vetë, sipas dispozitave dhe rregullave të përgjithshme të K.Pr.Civile, mandati i tij nuk do të kufizohej në kohë, për të garantuar edhe ushtrimin e këtij funksioni në vijimësi. Nga ana tjetër, sikundër parashikon neni 179/b, pika 8 e Kushtetutës, edhe pas mbarimit të Kolegjit, sërish çështjet e mbetura pa u shqyrtuar prej tij do të kalojnë për kompetencë në Gjykatën Kushtetuese, e cila do të gjykojë edhe në këtë rast, sipas këtij parashikimi, ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, duke zëvendësuar juridiksion rivlerësues të Kolegjit. Parashikimi kushtetues, sipas këtij rregulli, synon posaçërisht kalimin e kompetencave Gjykatës Kushtetuese në mënyrë të kufizuar dhe si një kompetencë përjashtimore, e cila do të duhet, po ashtu, të përmbyllet brenda një kohe të caktuar, në përputhje me qëllimin e Kushtetutës për të kufizuar në kohë procesin e rivlerësimit. Kjo kompetencë e dhënë një organi që vepron në mënyrë të përhershme, siç është Gjykata Kushtetuese, nuk legjitimon dhe as tejkalon juridiksionin rivlerësues të Kolegjit, i cili transpozohet te Gjykata Kushtetuese mbi të njëjtat rregulla e njëjtën frymë dhe zhvillohet brenda të njëjtit kuadër ligjor. Në këtë kuptim, asnjë alternativë e ndryshme nuk mund të kishte relevancë, pasi do të vendoste një standard të ndryshëm në raport me rivlerësimin e subjekteve të tjerë, për të cilët procesi kishte përfunduar prej Kolegjit.

12.7. *Së treti*, trupi gjykues mban në konsideratë faktin se dispozitat procedurale që rregullojnë institutin e rishikimit, që si rregull i përkasin dhe synojnë të zgjidhin gabimet gjyqësore në rastet e konflikteve në fushën civile apo administrative, ku në çfarëdo rrethanash procesi ka kaluar nëpërmjet kontradiktoritetit mes palëve të ndryshme/kundërshtare gjyqësore të përfshira në konflikt. Në këtë frymë, kanë kuptim dhe efekt parashikimet e rasteve të renditura në nenin 494 të K.Pr.Civile, si shkaqe që justifikojnë cenimin e parimit *res judicata* të vendimeve, në favor të garantimit të parimit të dhënies së drejtësisë, po ashtu edhe afatet e përcaktuara në nenet 495 e 496 të po këtij Kodi, për paraqitjen e saj, me pasojë shuarjen e së drejtës. Të gjitha këto dispozita gjenden me vështirësi të zbatueshme në rastet e pretenduara

prej subjekteve të rivlerësimit, qoftë në drejtim të afateve të parashikuara, qoftë në drejtim të formës apo edhe të faktit që lidhet me dijeninë e subjekteve për provat e reja apo rrethanat e zbuluara që nuk diheshin. Procesi i rivlerësimit bazohet në një parim të ndryshëm procedural, për sa i përket barrës së provës, duke qenë se në mënyrë atipike në këtë proces barra e provës qëndron mbi subjektet e rivlerësimit, ndonëse procesi nisët kryesisht prej organeve të rivlerësimit. Në këtë kuptim, ligji prezumon dijeninë e plotë të subjekteve dhe barrën të provojnë faktet që janë të rëndësishme për procesin e tyre të rivlerësimit, i cili është një proces individual që merr në analizë momente jetësore të tyre. Në këtë logjikë, padijenit për disa fakte apo prova siç rendit përgjithësisht instituti i rishikimit, si shkak për ta zbatuar atë, duket jo relevant me këtë proces, në të cilin dijenia prezumohet për ngjarjet e jetës personale të secilit. Kjo analizë, ndonëse nuk është përcaktuese për qëndrimin e trupit gjykues mbi juridiksion rishikues të Kolegjit, sillet në vëmendje si një argument shtesë për të mbështetur konkluzionin se edhe për shkak të këtyre tipareve instituti i rishikimit nuk mund të jetë i zbatueshëm në procesin e rivlerësimit kalimtar, duke qenë se ai në të gjitha rastet e tij është parashikuar si një mjet i jashtëzakonshëm ankimi që vë në diskutim vendimet e formës së prerë të marra pas gjykimit të konflikteve civile/administrative që kanë ekzistuar mes palëve ndërgjyqësve e të shoqëruara në drejtim të procesit të të provuarit me të tjera rregulla për barrën e provës.

12.8. *Së katërti*, trupi gjykues, nga analiza e dispozitave procedurale, konstaton përveç të tjerave edhe mungesën e rregullimeve specifike për procedurën dhe krijimin e trupave gjykues që do të duhet të shqyrtonin kërkesat për rishikim, sipas parashikimeve të nenit 494 e vijues të K.Pr.Civile, duke disponuar paraprakisht për vlerësimin nëse janë kushtet për rishikim dhe më pas për gjykimin e themelit të çështjes, sipas parashikimeve të nenit 498 të kodit. Mungesa e një rregulli të posaçëm, lidhur me përcaktimin e procedurës së gjykimit të rishikimit në Kolegji, në kushtet kur Kolegji përbëhet prej 7 anëtarësh, vlerësohet prej trupit gjykues jo si *ometim* i ligjvënësit, por si shprehje e vullnetit se në procesin e rivlerësimit kalimtar instituti i rishikimit nuk do të bëjë pjesë në juridiksionin e Kolegjit.

12.9. Përfundimisht, lidhur me këtë çështje, trupi gjykues arrin në konkluzionin se as nga interpretimi sistematik e teleologjik i dispozitave të mësipërme nuk derivohej vullneti i ligjvënësit, sipas së cilit përcaktohet juridiksioni rishikues i Kolegjit, në përputhje me juridiksionin rishikues të gjykatave të zakonshme të vendit.

13. Lidhur me çështjen e tretë të shtruar për zgjidhje se, për shkak të konkluzioneve të mësipërme, *si mund të mbrohen të drejtat e subjekteve të rishikimit për një proces të rregullt ligjor, kur ato janë shkelur nga gjykimi i çështjeve të tyre në Kolegjin e Posaçëm të Apelit dhe të korrigjohet një gabim gjyqësor që shoqëron një vendim të dhënë me këto shkelje*, trupi gjykues analizon si vijon.

13.1. Trupi gjykues mori në analizë këtë çështje në funksion të mbajtjes së një qëndrimi lidhur me pretendimet që subjektet e rivlerësimit mund të kenë për të kundërshtuar vendimet e marra nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, si gjykata e vetme e këtij procesi. Nën dritën e kësaj analize, konstatohet se, së pari, në zbatim të parashikimit të nenit 116, pika 1, germa b e Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare bëjnë pjesë në të drejtën e brendshme, duke u

renditur në hierarkinë e ligjeve pas Kushtetutës së vendit, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut së bashku me mekanizmat e saj zbatues, ndër të cilat GjEDNj-ja, janë instrumente ligjorë të rëndësishëm për të garantuar zbatimin e parimit të procesit të rregullt ligjor nga gjykatat e brendshme, por edhe të parimeve të tjera që parashikon Konventa, në përputhje me nenin 17 e 42 të Kushtetutës. Në këtë kontekst, subjektet e rivlerësimit kanë të drejtë në parim të ankimojnë vendimet e Kolegjit në GjEDNj, në çdo rast që ata e konsiderojnë se vendimmarrja ndaj tyre ka qenë në shkelje të këtyre parimeve që Konventa merr përsipër të mbrojë e Kushtetuta e vendit të garantojë, për shkak të ratifikimit të marrëveshjeve ndërkombëtare që bëjnë Shqipërinë palë në të.

13.2. Përveç këtij rregulli të përgjithshëm të garantuar për subjektet e rivlerësimit, si për të gjithë shtetasit e tjerë të vendit, në nenin F, pika 8 e Aneksit të Kushtetutës, gjendet një parashikim i posaçëm, lidhur me këtë të drejtë të subjekteve, që i nënshtrohen procesit të rivlerësimit kalimtar. Sipas kësaj dispozite, e cila i është nënshtuar gjykimit kushtetues të bazuar në ekspertizën e Komisionit të Venecias, cituar në paragrafin 11.10 më lart: *Subjektet që rivlerësohen mund të ushtrojnë ankim në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.* Në vlerësimin e trupit gjykues, potencimi i kësaj të drejte në Aneksin e Kushtetutës, si legjislacioni i posaçëm që normon procesin e rivlerësimit, i shërben pikërisht identifikimit të mjetit mbrojtës e garantues për zbatimin e procesit të rregullt e parimeve të tjera të Konventës, në raport me vendimet e Kolegjit të Posaçëm, që do të barazohet në këtë rast me gjykatën e vetme e më të lartë në vend për juridiksionin e rivlerësimit.

13.3. Parashikimi i nenit F, pika 8 e Aneksit, konsiderohet si i vetmi mjet procedural që kanë në dispozicion subjektet e rivlerësimit në rast se të drejtat e tyre shkelen nga Kolegji në gjykimin e çështjeve të tyre dhe si e vetmja mundësi për të korrigjuar çdo gabim gjyqësor që mund të jenë konstatuar, në analogji me rastet që i përkasin gjykimeve nga gjykatat e zakonshme.

13.4. Parashikimi i mësipërm i bërë në mënyrë të posaçme, e që drejton subjektet drejt GjEDNj-së, konfirmon natyrën e jashtëzakonshme të procesit, përjashtimin nga rregullat e zakonshme procedurale dhe orientimin e adresimit në këtë gjykatë të çdo problematike që është konstatuar përgjatë procesit e që ka çuar edhe në një gabim gjyqësor. Koha në dispozicion e subjekteve për të ushtuar këtë të drejtë, e cila përkon me atë që parashikohet nga neni 46 i KEDNj-së, vjen në harmoni me natyrën e jashtëzakonshme të procesit, kufizimet që vijnë nga përmbysja e parimit të barrës të provës, kufizimeve në të drejtën për respektim të jetës private, sipas parashikimit kushtetues të nenit A të Aneksit të Kushtetutës, por që gjithsesi mbeten të mbrojtura deri në nivelin e kufizimeve të Konventës, sipas parashikimit të nenit 17 të Kushtetutës. Në këtë optikë, ankimi në GjEDNj mbetet mekanizmi i vetëm ligjor për adresimin e kundërshtive ndaj vendimeve të marra nga organet e brendshme, përfshi edhe vendimet e Kolegjit, si vendimet përfundimtare për efekt të këtij procesi.

13.5. Subjektet që ushtrojnë këtë të drejtë dhe që arrijnë të marrin një vendim të suksesshëm, që konstaton shkelje të neneve të Konventës në procesin e zhvilluar dhe orienton rihapjen e procesit nga gjykata e brendshme, në këtë rast Kolegji, si mundësia për të dëmshpërblyer

aplikantin për shkeljen e pësuar, janë të legjitimuar sipas leximit të këtij parashikimi kushtetues, në harmoni me nenin 494, germa “ë” e K.Pr.Civile, të kërkojnë rishikimin e vendimeve të Kolegjit për shkak të urdhërimit ligjor të dispozitave si më sipër analizuar. Përdorimi i këtij ankimi të jashtëzakonshëm në këto raste vjen si pasojë e zbatimit të detyrimeve që i vijnë shtetit shqiptar nga ratifikimi i marrëveshjeve ndërkombëtare dhe angazhimi i marrë prej tij në kuadër të tyre. Thirrja në zbatim e nenit 494, germa “ë” e K.Pr.Civile në këtë rast vjen si nevojë e zbatimit të drejtpërdrejt të KEDNJ-së dhe nenit F, pika 8 e Aneksit të Kushtetutës .

13.6. Në nenin 494 të K.Pr.Civile, në shkronjën “ë”, parashikohet se pala e interesuar mund të kërkojë rishikimin e një vendimi që ka marrë formë të prerë *kur Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut gjen shkelje të konventës evropiane “Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore” dhe të protokolleve të saj, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.* Nën dritën e këtij parashikimi, trupi gjykues gjen me vend të theksojë si vijon. *Së pari*, për trajtimin e të drejtave themelore të njeriut, GjEDNJ-ja në sistemin tonë juridik ka një kompetencë ekskluzive. Kushtetuta në nenin 122 përcakton epërsinë e marrëveshjeve ndërkombëtare në rendin juridik të brendshëm dhe sjell si detyrim që vendimet e GjEDNJ-së të zbatohen drejtpërsëdrejti nga të gjithë organet shtetërore të Republikës së Shqipërisë, përfshirë gjykatat e të gjithë niveleve e, po ashtu, edhe gjykatat me juridiksion specifik siç është Kolegji. *Së dyti*, procesi i rivlerësimit kalimtar vëzhgohet dhe monitorohet nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit, parashikuar nga kuadri kushtetues dhe ligjor i rivlerësimit. Roli dhe kompetencat e këtij organizmi jo vendimmarrës janë garanci e shtuar për mbrojtjen e interesave të subjekteve që i nënshtrohen procesit të rivlerësimit dhe kryerjen e tij në respektim të parimeve të procesit të rregullt ligjor. Sa më sipër, për sa kuadri kushtetues dhe ligjor i rivlerësimit, institucionet që e kryejnë atë, japin garanci maksimale për të shmangur shkaqet e parashikuara në 6 gerrat e para të nenit 494 të K.Pr.Civile, konkludohet që jo pa qëllim kushtetutbërësi ka parashikuar ankimin ndaj vendimeve të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit në GjEDNJ. *Së treti*, për sa sipëranalizuar, nga leximi harmonik i nenit 179/b të Kushtetutës, nenit F të Aneksit të Kushtetutës, ligjit nr. 84/2016, nenit 494, germa “ë” të K.Pr.Civile, Kolegji do të kishte juridiksion rishikues vetëm mbi bazë të një vendimi të GjEDNJ-së që potencialisht do të konstatonte se ekzistojnë shkaqet e tjera që përlligjin shqyrtimin e një vendimi të formës së prerë të tij, nëpërmjet rihapjes së procesit, si mënyra e përcaktuar si dëmshpërblim për të drejtën e shkelur.

14. Qëndrimi i mbajtur në deduksion të analizës së bërë më lart i jep përgjigje përfundimtare kërkesave të paraqita prej kërkuessit, Artor Ylli, për të cilin GjEDNJ-ja nuk ka marrë ende një vendim, se ato nuk mund të shqyrtohen nga Kolegji, për shkak të mospasjes prej tij të juridiksionit rishikues, sipas referimeve që kërkuessi bën në nenin 494, gerrat “a” dhe “c” të K.Pr.Civile.

14.1. Trupi gjykues e sheh me vend të sjellë në vëmendje faktin se analiza e mësipërme është kryer në kuadër të rastit objekt shqyrtimi edhe si një evoluim i jurisprudencës së Kolegjit, lidhur me trajtimin e institutit të rishikimit, i kondicionuar nga nevoja e pasjes së një qartësie, që lind për shkak të kundërshtimeve e vështirësive për aplikimin e tij në kuadër të procesit të

rivlerësimit të hasura deri në kohën e marrjes së këtij vendimi. Ky qëndrim vlen të nënvizohet se i jep përgjigje edhe çështjes së ngritur nga GjEDNJ-ja në çështjen *Sevdari kundër Shqipërisë*¹¹, lidhur me paraqitjen prej aplikantëve të kërkesave për rishikim brenda gjykatës së brendshme, si një parakusht për shqyrtimin e pretendimeve që mund të kualifikoheshin nën parashikimet e nenit 494 të K.Pr.Civile dhe jashtë fushës së veprimit të ankimeve të depozituara në GjEDNJ. Duke vlerësuar se ky qëndrim i gjykatës nuk vjen si detyrues për sistemin e brendshëm të ankimit, për sa kohë që mbi një çështje të tillë nuk ka pasur një qëndrim të gjykatës së vendit, në këtë rast Kolegjit, trupi gjykues e gjen të drejtë dhe brenda juridiksionit të gjykatës së vendit trajtimin rishtas të juridiksionit rishikues, pa rënë ndesh me jurisprudencën orientuese të GjEDNJ-së, e cila mund të ketë objekt kontrolli e vlerësimi këtë qëndrim në proceset e mëpasshme, në të cilat ai mund të kontestohet me pretendimin për shkelje të garancive që parashikon Konventa për një proces të rregullt ligjor.

15. Qëndrimi i mbajtur përfaqëson në këtë mënyrë një proces normal të zhvillimit të jurisprudencës, në përgjigje të kërkesave të paraqitura, numrit të tyre, natyrës dhe bazës ligjore të përdorur.
16. Pavarësisht të ndryshimit në analizën dhe qëndrimin mbi juridiksionin rishikues të Kolegjit që pengon marrjen në shqyrtim të kërkesave të kërkuarit, trupi gjykues e sheh të nevojshme si një *obiter dictum*, të konfirmojë se ndonëse shkaqet e rishikimit të paraqitura prej kërkuarit Artor Ylli nuk i nënshtrohen juridiksionit rishikues të Kolegjit, sipas arsyetimit të mësipërm, sërish ato konstatohen se janë të njëjta me shkaqet e marra në shqyrtim deri tani në jurisprudencën e Kolegjit në raste të ngjashme¹² dhe do të vlerësoheshin njësoj të pabazuara edhe nëse do t'i nënshtroheshin shqyrtimit gjyqësor mbi të njëjtat argumente të përdorua në këto raste.
17. Në përfundim, sipas analizës harmonike dhe të gjithanshme të dispozitave Kushtetuese dhe ligjore, si dhe orientimeve të instrumenteve ndërkombëtarë, që kanë normuar procesin e rivlerësimit kalimtar, trupi gjykues vlerësoi se Kolegji i Posaçëm i Apelit mund të ketë juridiksion rishikues vetëm nëpërmjet zbatimit të Vendimeve të GjEDNJ-së në përgjigje të ankimit të vetë kërkuarit, në përputhje me parashikimet e nenit F, pika 8 e Aneksit të Kushtetutës, nenit 494, germa “ë” të Kodit të Procedurës Civile dhe detyrimeve që shteti shqiptar ka marrë përsipër në kuadër të zbatimit të KEDNJ-së. Situatat e tjera të parashikuara nga legjislati brendshëm, për t'u zbatuar si rrethana për rishikimin e vendimeve civile/administrative të marra në përfundim të një procesi kontradiktor, u vlerësuan se nuk gjejnë zbatim brenda kontekstit të procesit të rivlerësimit, i cili është një proces i jashtëzakonshëm i realizuar prej organeve me mandat të kufizuar dhe që zhvillohet brenda një kuadri ligjor që përfshin edhe kufizimet e parashikuara nga neni A i Aneksit të Kushtetutës.
18. Për sa më lart, trupi gjykues arriti në përfundimin se kërkesat e paraqitura prej kërkuarit Artor Ylli nuk bëjnë pjesë në juridiksionin e rivlerësimit kalimtar të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, sipas përcaktimit të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenit F, pika 1 e Aneksit të

¹¹ *Shih vendimin e GjEDNJ-së në çështjen Sevdari kundër Shqipërisë, paragrafët 110-112.*

¹² *Vendimet e Kolegjit nr. 34, datë 06.12.2023, që i përket kërkuarës R. G dhe nr. 4, datë 15.02.2024, që i përket kërkuarës A. G.*

Kushtetutës dhe as në juridiksion rishikues të Kolegjit, sipas përcaktimit të nenit F, pika 8 e Aneksit të Kushtetutës e nenit 494, shkronja “ë” e Kodit të Procedurës Civile, për pasojë ato konsiderohen të papranueshme.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji, bazuar në nenin 498, pika 1 të Kodit të Procedurës Civile,

V E N D O S I:

Mospranimin e kërkesave të kërkuarit Artor Ylli, për rishikimin e vendimit nr. 31 (JR), datë 20.11.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, të regjistruara me nr. 2-4/2019 (JR), datë regjistrimi 10.01.2022 dhe nr. 143/2 prot., datë 14.02.2024.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 19.04.2024.

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

RELATORE

Ina RAMA

nënshkrimi

KRYESUESE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

MENDIM PARALEL

1. Unë, gjyqtare Natasha Mulaj, jam dakord me vendimin nr. 12 (JR), datë 19.04.2024, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim “Kolegji”) për: *“Mospranimin e kërkesave të kërkuarit Artor Ylli për rishikimin e vendimit nr. 31 (JR), datë 20.11.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit”, me nr. 2-4/2019 (JR), datë regjistrimi 10.01.2022 dhe nr. 143/2 prot., datë 14.02.2024”, por me një arsyetim ndryshe lidhur me arsyet se përse këto kërkesa për rishikim të kërkuarit nuk duhen pranuar nga Kolegji, sipas parashikimeve të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksit të saj dhe ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.*
2. Për të konkluduar, nëse Kolegji ishte i pajisur me tagrat kushtetuese dhe ligjore për të pasur pjesë të juridiksionit të tij, rishikimin e vendimeve të marra po prej Kolegjit sipas dispozitave të legjislationit të zbatueshëm të procesit të rivlerësimit, si dhe parashikimeve të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile, në vendim, trupi gjykues i Kolegjit shtroi për zgjidhje tri çështje: (i) nëse ka një parashikim ligjor që përcakton juridiksionin rishikues të Kolegjit ndaj vendimeve të dhëna prej tij; (ii) nëse me anë të një interpretimi teleologjik të dispozitave kushtetuese dhe ligjore mund të arrihet në përfundimin se Kolegji e ka fituar këtë juridiksion rishikues; (iii) si mund të mbrohen të drejtat e subjekteve të rishikimit për një proces të rregullt ligjor, kur ato janë shkelur nga gjykimi i çështjeve të tyre në Kolegji dhe të korrigjohet një gabim gjyqësor që shoqëron një vendim të dhënë me këto shkelje.

2.1. Si gjyqtare me mendim paralel, mbështes dhe shpreh dakordësinë me arsyetimin dhe konkluzionin e arritur nga trupi gjykues për dy çështjet e para, për të cilat u arrit në përfundimin se:

11.14 [...] trupi gjykues arrin në konkluzionin se dispozitat e Kushtetutës, Aneksit të saj dhe ligjit nr. 84/2016, lidhur me procesin e rivlerësimit kalimtar, parashikojnë dhe përcaktojnë në mënyrë të shprehur vetëm juridiksionin rivlerësues të Kolegjit lidhur me kontrollin ndaj vendimeve të marra prej Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, juridiksion i ushtruar mbi ankimin e subjekteve të rivlerësimit dhe Komisionerëve Publikë. Nga analiza e kuadrit rregullator të posaçëm, nuk rezulton të ketë asnjë parashikim eksplicit për ushtrimin e juridiksionit rishikues të Kolegjit sipas kërkesës së parashikuar prej kërkuarit Artor Ylli në çështjen objekt shqyrtimi. Mungesa e një parashikimi të tillë në ligjin e posaçëm, e shoqëruar edhe me mungesën e rregullave për trajtimin e kërkesa të tilla, e çoi trupin gjykues në nevojën e analizës së dispozitave që thirren për zbatim me referim, nëse nëpërmjet tyre, mund të aplikohet/ushtrohet ky juridiksion rishikues i pretenduar prej kërkuarit.

12.9. Përfundimisht, lidhur me këtë çështje, trupi gjykues arrin në konkluzionin se as nga interpretimi sistematik e teleologjik i dispozitave të mësipërme [kushtetuese dhe ligjore], nuk derivohet vullneti i ligjvënësive sipas të cilit përcaktohet juridiksioni rishikues i Kolegjit, në përputhje me juridiksionin rishikues të gjykatave të zakonshme të vendit.

Në vlerësimin tim, arsyetimi dhe konkluzioni i trupit gjykues, lidhur me çështjen objekt shqyrtimi, duhet të kishte përfunduar këtu.

2.2. Qëndrimi im i ndryshëm lidhet me arsyetimin me të cilin trupi gjykues vendosi për t'i dhënë zgjidhje çështjes së tretë të ngritur për diskutim dhe konkluzionin se: *Kolegji mund të ketë juridiksion rishikues vetëm nëpërmjet zbatimit të vendimeve të GjEDNj-së, në përgjigje të ankimit të vetë kërkuarit, në përputhje me parashikimet e nenit F, pika 8 e Aneksit të Kushtetutës, nenit 494, germa "ë" e Kodit të Procedurës Civile dhe detyrimeve që shteti shqiptar ka marrë përsipër në kuadër të zbatimit të KEDNj-së.*

2.3. Ky arsyetim dhe konkluzion i trupit gjykues, përveç inkoherent me konkluzionet e arritura për dy çështjet e para, vjen dhe si pasojë e një diferencimi dhe interpretimi alogjik të situatave të parashikuara në nenin 494 të Kodit të Procedurës Civile, duke i atribuar Kolegjit mundësinë e rishikimit vetëm për rastin e parashikuar nga shkronja "ë" e kësaj dispozite, kur Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut gjen shkelje të Konventës Evropiane "Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore" dhe të protokolleve të saj, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë. Kjo qasje e trupit gjykues, në vlerësimin tim si gjyqtare me mendim paralel, është e gabuar, pasi Kolegji nuk mund të aplikojë mekanizma që nuk ia njeh Kushtetuta dhe ligji për ta bërë të zbatueshëm vendimin e GjEDNj-së.

3. Pavarësisht se qëndrimi i trupit gjykues mbi këtë çështje specifike lidhet me detyrimet që burojnë nga neni 46 i KEDNj-së dhe neni 122 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të cilët parashikojnë zbatimin e vendimeve të GjEDNj-së, dhe për të cilat, unë si gjyqtare mbetem e angazhuar maksimalisht për t'i përmbushur ato me qëllim dhënien e drejtësisë dhe respektimin e të drejtave të njeriut, vlerësoj se, në mungesë të një referimi ligjor të juridiksionit rishikues të Kolegjit, rishikimi në këtë rast është jo i zbatueshëm dhe nuk mund të aplikohet nga ana e Kolegjit.
4. Ndonëse GjEDNj-ja, në disa nga vendimet e saj të deritanishme lidhur me procesin e rivlerësimit kalimtar, referon që rihapja e çështjes, nëse kërkohet nga pala, përfaqëson në parim një mënyrë të përshtatshme për rregullimin e shkeljes, duhet theksuar se sërish kjo referencë mbetet në nivel rekomandues dhe si e tillë duhet vlerësuar deri në pikën që lejohet nga ligji vendas, pasi është në diskrecionin e shtetit shqiptar të zgjedhë vetë mjetet për të përmbushur detyrimet që burojnë nga vendimet e GjEDNj-së.
5. Do të doja të theksoja në këtë mendim paralel, për sa trajtuar më sipër, se jo pa qëllim kushtetutëbërësi nuk e ka çmuar të zbatueshëm institutin e rishikimit për vendimet e Kolegjit, duke mos e trajtuar në asnjë dispozitë kushtetuese dhe ligjore. Peshë të rëndësishme në këtë proces rivlerësimi, ka qenë e drejta për një proces të rregullt ligjor për subjektet e rivlerësimit.
6. Për sa më sipër, si gjyqtare me mendim paralel, vlerësoj se mbetet detyrë pikërisht e ligjvënësit për të rregulluar këtë situatë të krijuar, duke rishikuar kuadrin ligjor aktual me qëllim përfshirjen e parashikimeve ligjore, duke përcaktuar gjykatën kompetente dhe modalitetet respektive për kryerjen e rishikimit të vendimeve të Kolegjit, të kërkuara nga subjektet e

rivlerësimin në raport me të gjitha rrethanat e nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile. Në kushtet kur ligjvënësi nuk i ka atribuar Kolegjit juridiksion rishikues, ndaj mendimin se ky institucion nuk mund të ushtrojë këtë tagër ndaj vendimeve të tij.

GJYQTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

MENDIM PARALEL

1. Unë, gjyqtare Albana Shtylla, jam dakord me zgjidhjen e çështjes për vendimin nr. 2-4/2019 (JR), datë 10.01.2022, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, me të cilin është vendosur mospranimi i kërkesave të kërkuarit Artor Ylli, për rishikimin e vendimit nr. 31 (JR), datë 20.11.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, me nr. 2-4/2019 (JR), datë regjistrimi 10.01.2022 dhe nr. 143/2 prot., datë 14.02.2024, por kam mendim paralel, lidhur me arsyetimin e shumicës së trupit gjykues, për sa parashtruar në vijim.
2. Shumica e trupit gjykues në përfundim ka konkluduar se *Kolegji i Posaçëm i Apelimit mund të ketë juridiksion rishikues vetëm nëpërmjet zbatimit të vendimeve të GjEDNj-së, në përgjigje të ankimit të vetë kërkuarit, në përputhje me parashikimet e nenit F, pika 8 e Aneksit të Kushtetutës, nenit 494, germa “ë” e Kodit të Procedurës Civile dhe detyrimeve që shteti shqiptar ka marrë përsipër në kuadër të zbatimit të KEDNj-së. Situatat e tjera të parashikuara nga legjislacioni i brendshëm, për t’u zbatuar si rrethana për rishikimin e vendimeve civile/administrative të marra në përfundim të një procesi kontradiktor, u vlerësuan se nuk gjejnë zbatim brenda kontekstit të procesit të rivlerësimit, i cili është një proces i jashtëzakonshëm i realizuar prej organeve me mandat të kufizuar dhe që zhvillohet brenda një kuadri ligjor që përfshin edhe kufizimet e parashikuara nga neni A i Aneksit të Kushtetutës.*
3. Në ndryshim nga shumica, në analizë harmonike të dispozitave kushtetuese, ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji “nr. 84/2016”) dhe legjislacionit në fuqi, kam vlerësuar se Kolegji i Posaçëm i Apelimit ka juridiksion rishikues për të shqyrtuar kërkesat për rishikim bazuar në të gjitha rrethanat e parashikuara të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile. Ky qëndrim bazohet në argumentet si vijojnë.
4. Referuar përcaktimit të nenit F, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, Kolegji i Posaçëm i Apelimit (në vijim “Kolegji”) është organi i vetëm gjyqësor që shqyrton ankimet kundër vendimeve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) dhe zgjidh çështjen përfundimisht në sistemin e brendshëm gjyqësor.

4.1. Sipas nenit 179/b të Kushtetutës, sistemi i rivlerësimit u ngrit me qëllim garantimin e shtetit të së drejtës, pavarësinë e sistemit të drejtësisë, si dhe rikthimin e besimit të publikut te ky sistem. Ligjvënësi në nenin 179/b të Kushtetutës, si dhe në nenin 4, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 ka përcaktuar se procesi i rivlerësimit kalimtar kryhet në përputhje me parimet e procesit të rregullt ligjor, si dhe duke respektuar të drejtat themelore të subjekteve të rivlerësimit. Kolegji, si gjykata e vetme e procesit të rivlerësimit, shqyrton dhe konkludon në vlerësim të shkaqeve të ankimit, si gjykatë fakti bazuar në provat dhe ligjin e zbatueshëm, por edhe si një gjykatë që gjatë shqyrtimit të ankimit garanton të drejtat dhe liritë themelore, si dhe një proces të rregullt ligjor për subjektet e rivlerësimit. Gjykata Kushtetuese ka arsyetuar se: [...] *Megjithatë, duke*

pasur parasysh kompetencat e KPA-së si organi që kontrollon vendimmarrjen e KPK-së, vlerësohet se ky proces kontrollohet edhe nga pikëpamja e pajtueshmërisë së tij me Kushtetutën”¹³.

4.2. Bazuar në sa më sipër, vlerësoj se ligjvënësi nëpërmjet përcaktimeve në dispozitat kushtetuese dhe të ligjit nr. 84/2016 ka konfiguruar një gjykatë e cila zbaton të gjitha garancitë procedurale të një gjykate fakti, duke përthithur në të njëjtin gjykim dhe shqyrtimin e çdo pretendimi që do të paraqitet në kuadër të një ankimi kushtetues individual. Përcaktimi i mësipërm kushtetues dhe ligjor dëshmon për një vullnet të ligjvënësit për garantimin e parashikimeve të nenit 42 të Kushtetutës, si dhe detyrimeve që burojnë nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim “KEDNj”).

4.3. Në konsideratë të sa më sipër, kam vlerësuar se Kolegji, si gjykata e vetme e procesit, nëpërmjet një procesi të rregullt ligjor, garanton gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes të drejtat themelore të subjekteve të rivlerësimit, përfshirë dhe të drejtën për akses në gjykatë, sipas nenit 6/1 të KEDNj-së. Ashtu siç edhe ka theksuar Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim “GjEDNj”), e drejta për akses në gjykatë duhet të jetë “konkrete dhe efektive”, ndërkohë që efektshmëria e së drejtës për akses kërkon që një individ të “gëzojë mundësinë e qartë dhe konkrete për të kundërshtuar një ndërhyrje në të drejtat e tij”¹⁴. Në zbatim të jurisprudencës së GjEDNj-së, e drejta për të ankimuar një ndërhyrje në të drejtat e një individi, si dhe zgjidhja e çështjes në gjykatë garantohet, ndër të tjera, edhe nëpërmjet njohjes së të drejtës për mjete efektive të ankimit, qofshin ato të zakonshme apo edhe të jashtëzakonshme.

4.4. Neni 43 i Kushtetutës garanton të drejtën e ankimit si një nga të drejtat themelore të individit, e cila mbi bazën e parashikimit kushtetues gjen zbatim edhe në dispozitat materiale e procedurale të legjislacionit në fuqi. Kushtetuta garanton të drejtën e ankimit, duke mbajtur parasysh dhe sigurinë juridike dhe parashikueshmërinë e sistemit juridik, me qëllim që palëve t’u sigurohet ankim efektiv, për çdo cenim të drejtë/interesi të ligjshëm, si dhe për një zgjidhje të drejtë të çështjes. Sa i përket parimit të parashikueshmërisë dhe qartësisë së sistemit të së drejtës për të shfrytëzuar mjetet e ankimit, çdo individ duhet të ketë mundësinë dhe qartësinë për mjetet e mundshme të ankimit dhe kushtet që duhet të plotësojë për ushtrimin e tyre në interes të tij.

5. Në vijim të sa më sipër, në ndryshim nga shumica, vlerësoj se në një analizë harmonike të nenit A dhe nenit F, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, me parashikimet e neneve 4 paragrafi 6, 63, 64 e 65 të ligjit nr. 84/2016, subjekteve të rivlerësimit u njihet e drejta për akses në gjykatë bazuar në legjislacionin në fuqi, jo vetëm për të ankimuar vendimet e Komisionit pranë Kolegjit, por edhe për të ushtruar rishikimin si një mjet i jashtëzakonshëm ankimi, ndaj një vendimi të gabuar të Kolegjit dhe për një zgjidhje të drejtë të çështjes së tyre. Për rrjedhojë, Kolegji ka juridiksion

¹³ Shih vendimin nr. 2/2017, paragrafi 68, të Gjykatës Kushtetuese.

¹⁴ Bellet kundër Francës, paragrafët 36 dhe 38), Nunes Dias kundër Portugalisë (déc.)

rishikues dhe kompetencë për të kontrolluar vendimin e tij, bazuar në rrethanat e përcaktuara në mënyrë shteruese në nenin 494 të Kodit të Procedurës Civile.

5.1. Ligjvënësi në nenin A të Aneksit të Kushtetutës ka përcaktuar se: *“Me qëllim kryerjen e procesit të rivlerësimit, zbatimi i disa neneve të kësaj Kushtetute, veçanërisht i neneve që lidhen me të drejtën për respektimin e jetës private, si dhe nenet 36 dhe 37, dispozitat që lidhen me barrën e provës, nenet 128, 131, nënparagrafi “f”, 135, 138, 140, 145, paragrafi 1, 147/a, paragrafi 1, nënparagrafi “b”, 149/a, paragrafi 1, nënparagrafi “b”, kufizohen pjesërisht, sipas nenit 17 të Kushtetutës”*. Duket se ligjvënësi në përcaktimet e nenit A të Aneksit të Kushtetutës ka pasur në konsideratë se kufizimi apo ndalimi i një të drejte themelore apo një garancie procedurale të mbrojtur nga Kushtetuta dhe KEDNj-ja, duhet të bëhet me ligj, bazuar në nenin 17 të Kushtetutës, si dhe në zbatim të parimit të sigurisë juridike, por dhe të parashikueshmërisë për mjetet efektive.

Nga parashikimi i mësipërm i Aneksit të Kushtetutës nuk evidentohet që ligjvënësi të ketë kufizuar apo ndaluar në mënyrë eksplicite rishikimin si një mjet efektiv i jashtëzakonshëm i ankimit, ashtu siç ka bërë për të drejta të tjera, si ajo e parashikuar në nenin 131, nënparagrafi “f”, për ankimin kushtetues individual pranë Gjykatës Kushtetuese. Në të njëjtën mënyrë ka vepruar ligjvënësi edhe lidhur me institutin e “barrës së provës”, për të cilin, jo vetëm ka parashikuar kufizimin në nenin A të Aneksit të Kushtetutës, por edhe ka detajuar në nenin Ç, pika 5 të tij që në këtë proces barrën e provës e ka subjekti i rivlerësimit, si dhe më tej në nenin 52, paragrafi 3 të ligjit nr. 84/2016, ka përjashtuar në mënyrë eksplicite zbatimin e nenit 82 të Kodit të Procedurës Administrative. Këto parashikime për institutin e “barrës së provës” dëshmojnë se nëse ligjvënësi kishte për qëllim të ndalonte të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një mjet efektiv të jashtëzakonshëm ankimi, siç është rishikimi i vendimit, ai ka qenë i qartë për mënyrën si duhet të normohej kufizimi apo ndalimi i një të drejte apo garancie procedurale në kuadër të procesit të rivlerësimit.

5.2. Gjithashtu, rezulton se kufizimi apo ndalimi për rishikimin e vendimit, si një mjet efektiv ankimi, nuk është parashikuar edhe në asnjë dispozitë të ligjit nr. 84/2016. Ligjvënësi në nenet 62, 63, 64 e 65 të ligjit nr. 84/2016 ka rregulluar në mënyrë të posaçme vetëm mjetin e zakonshëm të ankimit, duke përcaktuar në përmbajtjen e këtyre dispozitave subjektet procedurale që mund të ushtrojnë këtë të drejtë, organin pranë të cilit depozitohet ankimi, afatet në të cilat ushtrohet kjo e drejtë, procedurën e njoftimit të ankimit etj. Mosparashikimi në mënyrë eksplicite në ligjin nr. 84/2016 i të drejtës për rishikimin e vendimit të Kolegjit nuk duket se ka pasur për qëllim kufizimin apo ndalimin e kësaj të drejte për subjektet e rivlerësimit, përkundrazi mungesa e një rregullimi të posaçëm kufizues apo ndalues lejon mundësinë e ushtrimit të këtij mjeti të jashtëzakonshëm ankimi.

Ky qëndrim bazohet dhe në argumentin që ligjvënësi në ligjin nr. 84/2016, duket se nuk ka ndjekur një model të një ligji me parashikime shteruese të gjithë të drejtave dhe garancive procedurale të subjekteve të rivlerësimit. Për këtë arsye, neni 4 paragrafi 6 i po këtij ligji ka parashikuar se: *Kur është rasti, institucionet e rivlerësimit mund të zbatojnë edhe procedurat e*

parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative ose në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, nëse këto procedura nuk janë parashikuar nga dispozitat e Kushtetutës ose të këtij ligji. Në referim të përcaktimeve të nenit 4, paragrafi 6 të ligjit nr. 84/2016, nenit 1, paragrafi 2 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”) dhe nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile, ligjvënësi ka njohur garancinë procedurale të ushtrimit të rishikimit të vendimit, si një mjet i jashtëzakonshëm ankimi.

5.3. Sa i përket kompetencës lëndore të Kolegjit për rishikimin e vendimit, kam vlerësuar se ajo është e rrjedhur nga fakti që Kolegji është gjykata që ka shqyrtuar në themel ankimin ndaj vendimit të Komisionit. Referuar nenit 497, paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Civile *Kërkesa për rishikim paraqitet para gjykatës së shkallës së parë që ka dhënë vendimin, por në rast se vendimi është ankimuar në gjykatat më të larta, kompetente është gjykata më e lartë që ka shqyrtuar çështjen në themel. Gjykata kompetente për shqyrtimin e kërkesës për rishikim gjykon sipas rregullave të zbatueshme për atë shkallë gjykimi.*

Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 2/2017 ka argumentuar se: [...] Në nenin 43 të Kushtetutës parashikohet se “kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj për kundërvajtje të lehta penale, për çështje civile ose administrative me rëndësi ose vlerë të vogël, në përputhje me kushtet e parashikuara në nenin 17 të Kushtetutës”. [...] Ajo duhet kuptuar si mundësi e çdo individi për të pasur mjete të caktuara procedurale për të kundërshtuar vendimin e dhënë nga një gjykatë më e ulët në një gjykatë më të lartë, duke i garantuar individit të drejtën për t’u përballur me drejtësinë në të gjitha nivelet e saj. [...] **Gjykata vlerëson se nga mënyra e cilësimit të Kolegjit të Apelit në Kushtetutë dhe në ligjin për rivlerësimin kalimtar, këto tekste ligjore parashikojnë elemente të mjaftueshme për të arritur në përfundimin se ai mund të konsiderohet si një juridiksion i posaçëm, i cili u jep garanci gjyqësore personave të prekur nga procedura e rivlerësimit dhe se të drejtat dhe garancitë e përfshira në skemën legjislative dhe kushtetuese duket se janë mjaft të gjera (shih edhe opinionin CDL-AD (2016)036 të Komisionit të Venecias)”**¹⁵.

Pra, Gjykata Kushtetuese në interpretimin e saj pajtues për ligjin nr. 84/2016 ka theksuar që pavarësisht se Kolegji është një gjykatë me juridiksion të posaçëm, ai u jep garanci gjyqësore personave të prekur nga procedura e vlerësimit, bazuar në një skemë të gjerë legjislative dhe kushtetuese, duke nënkuptuar dhe pranuar në interpretim harmonik me përcaktimet e nenit 4,

¹⁵ Shih vendimin nr. 2/2017, paragrafët 65 dhe 66, të Gjykatës Kushtetuese.

Qëndrimi i Komisioni i Venecias, i referuar nga Gjykata Kushtetuese në këtë vendim, është si vijon: “Për sa i përket pyetjes nëse mungesa e mundësisë së gjyqtarëve dhe prokurorëve që i nënshtrohen procesit të vetting-ut për të kundërshtuar vendimet e marra nga institucionet e rivlerësimit para gjykatave kombëtare përbën shkelje të nenit 6 të KEDNj-së, Komisioni i Venecias konsideron se përgjigjja e kësaj pyetje varet nga mënyra e cilësimit të Kolegjit të Apelit në Kushtetutë dhe në Ligjin e Vetting-ut. **Për Komisionin e Venecias, këto tekste ligjore parashikojnë elemente të mjaftueshme për të arritur në përfundimin se Kolegji i Apelit mund të konsiderohet si një juridiksion i posaçëm, i cili u jep garanci gjyqësore personave të prekur nga procedura e vetting-ut. Të drejtat dhe garancitë e përfshira në skemën legjislative dhe kushtetuese duket se janë mjaft të gjera**”.

paragrafi 6 të ligjit nr. 84/2016, që brenda kësaj skeme legislative nuk është vetëm Aneksi i Kushtetutës dhe ligji nr. 84/2016, por dhe legjislacioni procedural përkatës, si ligji nr. 49/2012 apo Kodi i Procedurës Civile.¹⁶

5.4. Ndryshe nga shumica, e cila konsideron parashikimin e nenit F, pika 8 të Aneksit të Kushtetutës si dispozitën që kufizon ushtrimin e të drejtës së rishikimit të vendimit, vetëm në rastin/rrethanën e përcaktuar në nenin 494, germa “ë” të Kodit të Procedurës Civile, kam vlerësuar se qëllimi i këtij parashikimi nuk ka qenë kufizimi i rrethanave të rishikimit të vendimit të Kolegjit vetëm në rastet kur GjEDNi-ja ka marrë një vendim për kërkesën e paraqitur nga vetë subjekti.

5.4.1. Siç kam referuar më sipër në këtë mendim, ligjvënësi në nenin A të Aneksit të Kushtetutës, me qëllim kryerjen e procesit të rivlerësimit, subjekteve të rivlerësimit i ka kufizuar të drejtën sipas nenit 131, paragrafi “f” të Kushtetutës, pra, të drejtën për ankim kushtetues individual pranë Gjykatës Kushtetuese. Në vlerësimin tim, parashikimi i nenit F, pika 8 i Aneksit të Kushtetutës, ka pasur për qëllim të definojë dhe qartësojë në mënyrë të shprehur se ndryshe nga kontrolli kushtetues i realizuar në Gjykatën Kushtetuese, me ankime kushtetuese individuale ndaj vendimeve përfundimtare të sistemit të brendshëm gjyqësor, në juridiksionin e rivlerësimit, Kolegji është gjykata e cila përthith dhe shqyrtimin e shkaqeve apo pretendimeve të cilat mund të ngrihen nëpërmjet një ankimi kushtetues individual, ndaj vendimi i tij nuk mund të ankimohet në Gjykatën Kushtetuese, por në GjEDNj.

5.4.2. Duket se në të njëjtën mënyrë ka thirrur në interpretim pajtues përcaktimet e nenit F, pika 8 të Aneksit të Kushtetutës Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 2/2017, sipas së cilit: *“Në lidhje me të drejtën për ankim kushtetues individual, në vlerësimin e Komisionit të Venecias, Kushtetuta ka heshtur në lidhje me faktin nëse një subjekt mund të paraqesë një ankim individual para Gjykatës Kushtetuese dhe se në mungesë të një ndalimi nuk ka arsye për të përjashtuar një mundësi të tillë (paragrafi 44 i opinionit CDL-AD (2016)036). Në vlerësimin e Gjykatës, Kushtetuta nuk ka heshtur në lidhje me këtë drejtë, ashtu si edhe për disa të drejta të tjera kushtetuese. Gjykata vëren se, sipas nenit A të Aneksit të Kushtetutës me qëllim kryerjen e këtij procesi kufizohet edhe nënparagrafi “f” i nenit 131 të Kushtetutës, çka nënkupton se ky kufizim lidhet specifikisht me të drejtën e subjekteve që i nënshtrohen këtij procesi për t’iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese, kurse sipas nenit F, pika 8, po të Aneksit, subjektet që rivlerësohen mund të ushtrojnë ankim në GjEDNj. Vlerësimi nëse ky kufizim është proporcional apo jo nuk mund të jetë objekt i këtij gjykimi për sa kohë që ai jo vetëm është vendosur në rang kushtetues, por edhe sepse Gjykata nuk ka juridiksion për vlerësimin në themel të këtyre dispozitave, të cilat janë inkorporuar në Kushtetutë me anë të një ligji rishikues. Megjithatë, duke pasur parasysh kompetencat e KPA-së si organi që kontrollon*

¹⁶ Nëse referuar nenit 4, pika 6 dhe nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, ligji nr. 49/2012 nuk ka parashikime të posaçme.

*vendimmarrjen e KPK-së, vlerësohet se ky proces kontrollohet edhe nga pikëpamja e pajtueshmërisë së tij me Kushtetutën*¹⁷.

5.4.3. Nga ana tjetër, në vlerësimin tim, nëpërmjet këtij përcaktimi të Aneksit të Kushtetutës, gjen pasqyrim detyrimi i KEDNj-së, sipas së cilit çdo individ mund të paraqesë një ankim në GjEDNj, pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet efektive të brendshme, nëse pretendon se ka pasur cenim të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë akt ndërkombëtar të Këshillit të Evropës.

6. Bazuar në sa më sipër, në një interpretim harmonik të përcaktimeve të nenit F, pika 1 të Aneksit të Kushtetutës¹⁸, nenit 4, paragrafi 6 të ligjit nr. 84/2016, të referuar në paragrafin 5.2 më sipër, si dhe nenit 1, paragrafi 2 të ligjit nr. 49/2012, në konsideratë edhe të mungesës së parashikimeve eksplicite për kufizim të të drejtës së rishikimit vetëm në rrethanën e përcaktuar në germën “ë”, të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile, vlerësoj se Kolegji ka juridiksion rishikues për të gjitha rrethanat e përcaktuara në këtë dispozitë¹⁹.

Të njëjtin qëndrim ka mbajtur dhe GjEDNj-ja në çështjen *Sevdari kundër Shqipërisë* në paragrafin 46 të të cilit ka vlerësuar se: *“Në mbështetje të nenit 4(6) të Ligjit të Rivlerësimit, lexuar se bashku me nenin 1(2) të ligjit për Gjykatat Administrative (ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, organet e rivlerësimit, në rrethana të caktuara, mund të zbatojnë parashikimet e Kodit të Procedurës Civile. Neni 494 i Kodit të Procedurës Civile parashikon se një palë mund të kërkojë rishikimin e një vendimi, i cili është i formës së prerë në rrethana të caktuara, më konkretisht kur [...]”*²⁰.

Gjithashtu, GjEDNj-ja, në po këtë vendim në paragrafin 111, ka theksuar se: *Kërkuesja nuk paraqiti, pas vënies në dijeni për dyshimet në lidhje me përshtatshmërinë e L. D., për pozicionin e tij, një kërkesë për rishikim përjashtimor në vendimin e formës së prerë të KPA-së në çështjen e saj mbështetur në faktet e zbuluara rishtazi apo për ndonjë shkak tjetër të parashikuar në nenin 494 të Kodit të Procedurës Civile [...] (shih paragrafin 46 më sipër).*

7. Sa i përket rrethanave të tjera të sjella në vëmendje nga shumica lidhur me natyrën e jashtëzakonshme të këtij procesi, mandatin e kufizuar për realizimin e tij, edhe pse i konsideroj si argumente, të cilat bashkëshoqërojnë këtë proces për shqyrtimin e ankimeve ndaj vendimeve të Komisionit, në konsideratë edhe të argumenteve të trajtuara më sipër në këtë mendim, për mosparashikimin në mënyrë eksplicite të kufizimit të kësaj të drejte vetëm për rrethanën e parashikuar në nenin 494, germa “ë”, kam vlerësuar se ato nuk mund të mbështesin si të vetme qëndrimin për kufizimin e kësaj të drejte për z. Artor Ylli.

¹⁷ Shih vendimin nr. 2/2017, paragrafi 68, të Gjykatës Kushtetuese.

¹⁸ Kolegji si organi i rivlerësimit që shqyrton në themel ankimet ndaj vendimeve të Komisionit përthith juridiksionin dhe kompetencën rishikuese.

¹⁹ Qëndrim ky i mbajtur nga Kolegji dhe për kërkesat për rishikim vendimi të kërkuesve R. G dhe A. G.

²⁰ Me tej, GjEDNj-ja rendit të gjitha rrethanat e përcaktuara nga germa “a” në germën “ë” të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile.

Në përfundim, pavarësisht qëndrimit të mbajtur sa më sipër, shkaqet për rishikimin e vendimit të Kolegjit, të paraqitura prej kërkuarit Artor Ylli, ia nënshtrova vlerësimit në juridiksionin rishikues të Kolegjit, duke konkluduar se ato ishin të njëjta me shkaqet e marra në shqyrtim deri tani në jurisprudencën e Kolegjit në raste të ngjashme²¹, si dhe duke i konsideruar ato të pabazuara mbi të njëjtat argumente të përdorura në këto raste, duke vendosur mospranimin e tyre.

GJYQTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

²¹ Vendimi nr. 34, datë 06.12.2023, i Kolegjit, që i përket kërkuarës Rovena Gashi dhe vendimi nr. 4, datë 15.02.2024, i Kolegjit, që i përket kërkuarës Ana Gollosi.